



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 128/ Prot  
12

Tiranë, më 17/03/2015

REKOMANDIM

Nr. 12 datë 17/03 2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, në ngarkim të kontrolluesit, **Enti Rregullator i Energjisë (ERE)**,

KONSTATOVA:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka ushtruar hetim administrativ, në bazë ankesash të subjekteve të të dhënave personale dhe kryesisht, në ushtrim të kompetencave që ligji i jep, pranë kontrolluesit Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE). Si rezultat, në përfundim të hetimeve administrative, Komisioneri ka dalë sipas rastit me akte administrative, (rekomandim, vendim gjobe), si pasojë e moszbatimit dhe shkeljeve të konstatuara nga kontrolluesi, për sa i përket zbatueshmërisë të Ligjit Nr.9887, datë 10/03/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kundrejt subjekteve të të dhënave personale – konsumator apo klient.

Në këtë kuadër, nga verifikimi i kryer më datë 05/12/2014, në lidhje me zbatimin e detyrimeve të lëna në Rekomandimin nr. 28 datë 11/04/2014 të zyrës së Komisionerit, pranë kontrolluesit Operator i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), është konstatuar se ky kontrollues nuk ka zbatuar plotësisht, detyrimet sipas rekomandimit.

Në kundërshtim me detyrën e lënë në Rekomandim e cila lidhet me nenin 5 të ligjit 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, gjatë shërbimit "për ndryshimin e pronësisë së kontratës" që kontrolluesi i ofron klientëve, konstatohet se kontrolluesi OSHEE, vazhdon të mbledhë dhe arkivojë dokumenta pronësie të noterizuara dhe origjinale nga klientët.

Lidhur me moszbatimin e kësaj detyre të Rekomandimit, kontrolluesi ka paraqitur observacionin e tij në shkresën nr. 4542/1 prot datë 04/06/2014, të përcjellë pranë Zyrës së Komisionerit, duke argumentuar se, mbledhja e këtij dokumentacioni është përcaktuar në "Rregulloren e lidhjeve të reja", miratuar me vendimin nr. 22 datë 25/02/2012 të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë.

Nga këndvështrimi ligjor, në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale, është çmuar serioze shkelja që lidhet me, *mbledhjen dhe arkivimin e dokumenteve origjinale apo të noterizuara, që vërtetojnë pronësinë e objektit*, dhe për këtë arsye është realizuar një seancë e përbashkët



konsultimi me përfaqësuesit e ERE-s(me kërkesë të kësaj të fundit) dhe përfaqësues të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nga ky takim, nga shqyrtimi në tërësi i akteve ligjore dhe nënligjore mbi veprimtarinë e OSHEE-së dhe ERE-s, shqyrtimi i dosjes së përgatitur nga grupi i hetimit administrativ dhe shkresës së ERE-s nr. 124/1, datë 09.03.2015 me lëndë: *Mbi rishikimin e Rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes*, Zyra e Komisionerit vlerëson se;

*Mbledhja dhe arkivimi i dokumenteve origjinale apo të noterizuar që vërtetojnë pronësinë e objektit*, nga ana e kontrolluesit OSHEE, është një dokument alternativ për identifikimin e konsumit të energjisë elektrike nga ana e konsumatorit, dhe OSHEE në vazhdimësi, orientohet dhe saktëson detyrimet e konsumatorit edhe nëpërmjet:

- Kodit të klientit
- Nr.kontratës
- Numri i matësit
- Numri i vulës.

Dokumentacioni që kërkohet për lidhje të re, ose modifikim lidhjeje ekzistuese në Tension të Ulët për fuqi të instaluar deri në 20 kw, sipas Rregullores Nr.22, datë 25.02.2012, “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, miratuar me Vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, është si më poshtë vijon:

- 1.Kërkesë për furnizimin me energji elektrike (Formulari i Aplikimit).
- 2.Vertetim i identitetit (fotokopje e Kartës së identitetit ose pashaportës).
- 3.Fotokopje e Çertifikatë së regjistrimit në QKR (Për subjektet jofamiljare).
- 4.Gen-Plani i vendosjes së objektit.
- 5.Kopje e kontratës (kartelës) së mëparshme që aplikanti mund të ketë pasur.
- 6.Vertetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumentave të rregjistrimit të pronës, të tilla si: Akt shitje, akt qeraje, akt dhurimi ose akt ndarje prone të patundshme.

Në rastet kur Rregullorja e kërkon dokumentacionin fotokopje, (pika 2, pika 3, pika 5), kjo është shprehur dhe saktësuar me shkrim, kurse për vërtetimin e pronësisë, lë të nënkuptohet se kërkohet origjinali.

Në referim të praktikave europiane për këtë qëllim dhe, të sjella në vëmendjen tonë gjatë seancës së përbashkët, lehtësisht u konstatua, se këto praktika, nuk trysnonin konsumatorin, për vërtetimin e pronësisë në versionin origjinal apo kopje të noterizuar. Zyra e Komisionerit nuk është shprehur, kundër paraqitjes nga ana e konsumatorit, të dokumenteve që vërtetojnë pronësinë e objektit, të cilën konsumatori posedon, apo përdoruesi përdor, por këto nuk duhet të jenë të noterizuara apo origjinale kur arkivohen. Kjo edhe për faktin, se në këtë mënyrë, OSHEE, krijon një arkiv paralele të dokumentave të pronësisë (arkiv që ligjërisht disponohet nga tjetër autoritet publik) dhe kjo nuk është në objektin e veprimtarisë dhe nuk përputhet me qëllimin e veprimtarisë së kontrolluesit. Kontrolluesi, përsa i përket objekteve që posedojnë konsumatorët, të cilët marrin shërbimin e ofruar nga OSHEE, kur gjendet në rastet e verifikimeve të detyrueshme në lidhje me vërtetësinë e dokumentacionit, mund të gjej mënyra alternative të marrjes së informacionit në mënyrë më të institucionalizuar dhe një variant alternativ mund të jetë Ligji Nr.10325, datë 23.9.2010 “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore” mbi shkëmbimin e informacionit.

Në lidhje me aktet nënligjore që do të miratohen sipas ligjit të ri për sektorin e energjisë elektrike (sipas shkresës së ERE-s nr. 124/1, datë 09.03.2015 ), vlerësojmë që aktet, që kanë



lidhje me të dhënat personale, të dërgohen paraprakisht, për mendim pranë zyrës e Komisionerit. Kjo do të shërbejë për të hartuar dispozitat në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, në një plan më gjithëpërfshirës dhe afatgjatë në zbatim edhe të parashikimeve të Nenit 31/1 shkronja a dhe a/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 5, 6, 29, 30, 31 dhe 32 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të Kodit Procedurave Administrative:

### REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, Enti Rregullator Energjisë (ERE), të realizojë ndryshimin e Rregullores Nr.22, datë 25.02.2012, "Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes", kreu, "Dokumentacioni që kërkohet për lidhje të re, ose modifikim lidhjeje ekzistuese në Tension të Ulët për fuqi të instaluar deri në 20 kw", konkretisht në pikën 6, në mënyrë të tillë që të mos lejojë interpretim, mbi mënyrën e arkivimit të dokumentave të regjistrimit të pronës.
2. Ky detyrim të plotësohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit të këtij rekomandimi.
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, me plotësimin e detyrimit sipas pikës 1, të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Me kalimin e afatit të përcaktuar në pikën 2, në rast mos përmbushjeje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri, në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksione për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

